



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

-Sektori i Kuvendit-

01Nr. 060/01-17392/21
Kaçanik, 30.06.2021

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **VII-të (Shtatë)** e Rregullt e Kuvendit të Komunës Kaçanik për vitin 2021 (Legjislatura e VI-të), mbajtur me 30.06.2021. Mbledhja u mbajt në katin e tretë të objektit të komunës, në sallën e kuvendit, më fillim pune në ora 11:00.

Nga përbërja e përgjithshme e Kuvendit të Komunës prej 27 anëtarëve, pjesëmarrës në mbledhje ishin 26 anëtarë. Në mbledhje mungoj pa arsye anëtarja, Hafize Sallahi.

Prej strukturave ekzekutive të komunës, në mbledhje morën pjesë: Kryetari i Komunës-Besim Ilazi, drejtorët e drejtorive komunale; Ramadush Osmani, Festim Neziraj, Fatmir Loku, Bahri Selimi, Diana Reka dhe Zahir Doda, ndërkaq nga zyrtarët e komunës ishin: Bejtulla Dalloshi, Arbnora Kuka, Fatlume Guri-Selimi.

Nga strukturat vendore, mbledhja monitorohet përmes, Teleprezencës nga Gëzim Sahiti, Zyrtar i lartë për monitorimin e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës në MAPL.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Mërseli, Kryesues i Kuvendit,
Procesmbajtës, Makfire Malsiu, Zyrtare e Kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Mërseli, Të nderuar pjesëmarrës të kësaj mbledhje, së pari iu përshëndeti të gjithëve, iu dëshiroj mirëseardhje. Konstatoj pjesëmarrjen duke i thirrur emër për emër, prezentë në mbledhje janë 26 anëtarë, kushte pune me u mbajtur mbledhja ka, andaj e hapi mbledhjen e VII-të (Shtatë) të Rregullt për vitin 2021, data 30 Qershor, me këtë:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;
2. Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës (KABK) për vitet 2022-2024;
3. Propozim Rregullorë e brendshme për përdorimin e automjeteve zyrtare;
4. Propozim Vendimi për ndryshim plotësimin e vendimit 01Nr. 104/02-36179/19 - për emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve lokale, pas shqyrtimit të ankesave, kërkesave dhe propozimeve nga qytetarët e komunës së Kaçanikut;
5. Zëvendësimi i anëtares së KPF nga NISMA, Hafize Sallahi pas kalimit të saj në subjekt tjetër politik- AAK; dhe
6. Propozim Vendimi për rialokim të mjeteve, sipas buxhetit të vitit 2021.

Lidhur me rendin e punës e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë rendin e punës e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës e,

Aprovoj

Rendin e punës në përbërje prej 6 pikave.

U kalua në shqyrtimin e pikave sipas radhës:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;

Procesverbali i mbledhjes se kaluar të Kuvendit të Komunës u aprovua njëzëri pa vërejtje. Në sajë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës e,

Aprovoj

Procesverbalin e mbledhjes së VI-të (Gjashtë) të Rregullt të Kuvendit të Komunës të datës 15.06.2021 / Lënda: 01Nr. 60/01-15932/21.

Kryesuesi i Kuvendit, Para se me kaluar në pikët e dytë, procedojmë me;

Pyetje dhe Kërkesa

z. Ekrem Kyçyku, Faleminderit kryesues, iu përshëndes të gjithëve;

1. E kam një kërkesë prej banorëve të f. Llanishtë, për asfaltimin e rrugës, pasi që është i vetmi fshat që nuk e ka të asfaltuar rrugën kryesore. Ata pyesin se kur do të asfaltohet rruga ?

2. Disa banorë të lagjes Rakoci, të ura - të Matlumlë, kanë shqetësime natën së të rinjtë po rrinë të ura me llastra që është për këmbësor dhe kanë shqetësim për urën për shkak të nxehtësisë dhe zhurma që po krijohet është e padurueshme. Duhet me bërë një zgjedhje, ose me ngjitur llastrën me të trashë në pjesën metalike të urës.

z. Adnan Reka, Përshëndetje për të gjithë, unë i kam 1 Kërkesë dhe 1 Pyetje;

Ndonëse ju po bëni pastrimin e barërave në një pjesë të lumit Nerodime, ne konsiderojmë se një gjë e tillë është e pamjaftueshme, ne kërkojmë nga ekzekutivi komunal të bëjë deratizimin dhe dezinfektimin e komunës, sidomos përgjatë lumenjve dhe përroskave tejet të ndotura, të largojë qentë endacak nga rrugët e Komunës së Kaçanikut, dhe përmes kamerave të sigurisë dhe dëshmitarëve ta mbaj nën kontroll fenomenin e qenve endacak, sepse jemi bërë komunë ideale për qen, zvarranikë, brejtës dhe insekte.

Në anën tjetër kemi një paradoks, duam të shpenzojmë 30,000 euro për tabela elektronike 'Mirës vini në Kaçanik' dhe kjo vërtetë nuk shkon, në njërin anë qenë endacak, minjë, gjarpërinj dhe insekte, e në anën tjetër tabela elektronike.

Pyetja ime është, a doni t'ia jepni këto para ndonjë operatori që e keni si obligim ju Komunitat e qeverisura nga PDK ? apo nuk dini si ta shpenzoni 'buxhetin e mbijetesës' dhe e kopjoni Komunitat e Ferizajt, e cila ka buxhet 10 fish më të madh se Komunita jonë.

z. Bekim Koxha, Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë; Unë kam një brengë, tani është sezoni i verës dhe uji f. Koxhaj nuk mjafton, jemi në gjendje të mjerueshme. Çka duhet me bërë ekzekutivi me u marrë me këtë çështje, gypa kanë prur, por ujë nuk kanë prur. Ku qëndron problemi ? Pse nuk ka ujë ? Pse banorët e f. Koxhaj gjithmonë - që 20 vjet pas lufte nuk kanë ujë ? Drejtori i DSHPE duhet me dhënë llogari pse Elezajt kanë ujë, pse Koxhaj nuk kanë ujë ?

znj. Arlinda Rakoci-Raka, Përshëndetje për të gjithë; Unë e kam një pyetje dhe një kërkesë për DAK, Patet premtuar së me shtimin e stafit në çerdhen e fëmijëve "QEAP" Agimi" çerdhja e fëmijëve nuk do të mbyllet, por kjo nuk po ndodhë. Cila është arsyeja ? Kemi staf të mjaftueshëm, mund të bëni rokada në staf, sepse jo të gjitha nënat punojnë në arsim dhe nuk kanë pushim për 1 muaj e gjysmë sa kanë ato të arsimit dhe nuk kanë ku me i lënë fëmijët për periudhën sa qëndron e mbyllur çerdhja e fëmijëve. Disa nëna kanë bërë një Peticion dhe sot unë nuk munda me sjellë, por ato do të sjellin vet në zyre

znj. Nazife Krasniqi,

1. Edhe unë e kam një kërkesë, edhe parafolësit e theksuan për çështjen e ujit të pijes. Bekim e përmendi f. Koxhaj. Nuk është puna e mungesës së ujit në f. Koxhaj, edhe Elezajt nuk kanë ujë të pijes të afërmit e mijë. Kërkoj që mundësisht me bërë ndonjë zgjidhje, sepse çka donë me thënë në këto ditë të ngrohta me pasur probleme me ujë.

2. Shëtitores këtu në Kaçanik, në këta 2-3 muaj të nxehtë, duhet me iu kushtuar kujdes më tepër; pastrimit të lumit, ulëseve dhe ndriçimit publik, sepse një pjesë e ndriçimit publik nuk funksionon. Ulëset më i rregulluar e edhe pastrimi të lumenjve duhet me iu kushtuar kujdese gjatë sezonit së verës.

znj. Kaltrina Kodra (Tafili); Faleminderit shumë, përshëndetje; Unë po e përsërisë një kërkesë të cilën e kam ngritur gjatë këtyre 4 viteve edhe në Komitetin për Komunitete edhe në Kuvendin e Komunës. Shqetësimi im është së në vendkalimin mbi hekurudhë të SHM “Skënderbeu“ dhe të “ETC” nuk ka sinjalizues. Unë kam bërë kërkesë, me u vendosur sinjalizues, personalisht para një jave kam qenë të INFRAKOS dhe e kam pyetur; Pse nuk po vendosen disa sinjalizues në atë pjesë. Drejtori me ka thënë se kemi bërë kërkesë, mirëpo përgjegjës janë ata të INFRAKOS. Ata me thanë se nuk kemi pranuar kurrfarë kërkesë nga komuna me vendosur sinjalizues dhe ata (INFRAKOS) ishin të gatshëm me vendosur sinjalizues. Andaj, iu kisha lutur organeve kompetente për këtë çështje të adresojnë një kërkesë për sinjalizues, sepse ajo pjesë paraqet rrezik për kalimtarë, sidomos për banoret e asaj pjese dhe fëmijët të cilët kalojnë atypari për me shkuar në shkollë.

z. Agim Mani, Faleminderit shumë, përshëndetje; Unë i kam një pyetje dhe dy kërkesa;

1. Shprehi shqetësim sa i përket llogaridhënies. Në 4 takime të KK, unë kam bërë një pyetje, ndërkaq nuk kam marrë përgjigje.

2. Kërkesa tjetër është; Në rrugën e fshatit Stagovë, gjatë kryerjes së punimeve të shtruarjes se rrugëve me asfalt para 6 viteve, ka mbetur edhe një pjesë e rrugës për fazën e dytë. Kërkoj nga drejtoria e Shërbimeve Publike të jep një përgjigje rreth kësaj çështje.

3. Pengesat në rrugë në f. Stagovë, Kërkesa e qytetarëve ka qenë qysh në vitin e kaluar, për shkak se rruga është shumë e frekuentuar, ka pasur edhe raste me fatalitet, besoj si pasojë e pengesave në rrugë. Para 3-4 ditëve janë vendosur pengesa, por nuk është mbuluar tërë rajoni, Kërkoj që në atë lagje, në rrugën “Ekrem Gudaqi” të vendosën edhe 2 pengesa në rrugë.

z. Hajredin Luta, Faleminderit shumë, përshëndetje për të gjithë; Unë e kam një pyetje për drejtorin e DAP; Nëse dikush e nxjerrë një dokument për përmirësim të mbiemrit, sa dokumente duhet plotësuar për përmirësim të mbiemrit të fëmijës nën moshën 12 vjeç ? Është mirë me lëshuan njëfarë Udhëzimi se çka duhet nxjerrë pala për me nxjerrë atë dokument. Këtu nga shërbimi (ofiqtarisë) iu thuhet se duhet me nxjerrë një deklaratë me shkrim nga noteri. Unë pyeta në Ferizaj, ata thonë së nuk duhet shkuar përmes noterit. Unë e pyes drejtorin; Pse me shkuar përmes noterit ? Kur të shkon pala të noterit, faktikisht paguan 20 €, pse me paguar këtë shumë noterit, kur kjo është e mundshme me u kryer me dëshminë e dy prindërve. Pse me i maltretuar qytetarët për nxjerrjen e dokumentit të noterit, kur kjo nuk është në Ferizaj, pse me paguar 20 € pa nevojë.

z. Selim Reka, Faleminderit për të gjithë; Fillimisht e falënderoj drejtorin e DSHPE për kërkesën të cilën e kam ngritur në mbledhjen e kaluar për pasqyrën të Gjimnazi “ ajo është vendosur. Tani është shtruar një kërkesë e natyrës së njëjtë për rrugën kah lagja Kuka që shkon dhe bashkohet me rrugën e Llanishtës. Aty vërtetë është një rrezik i madh, sepse pjesa e rrugës që nuk shihet është bukur e madhe dhe kjo paraqet rrezik për qytetarët që kalojnë atypari.

Kryesuesi i Kuvendit, Pyetje dhe kërkesa të tjera nuk ka, atëherë kalojmë në pikën e radhës:

2. Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës (KABK) për vitet 2022-2024;

Kryesuesi i Kuvendit, drejtori është këtu, materialin e keni marrë, është një material i gjerë, e hapim diskutimin fillimisht, pastaj nëse ka nevojë për sqarime drejtori e merr fjalën;

z. Ekrem Kyçyku, Faleminderit kryesues: Me vjen mirë që disa sugjerime të cilat i kemi dhënë në KABK 2019-2021 janë përmirësuar lidhur me termet; si Lybeteni, Gjoli, ndërkaq kanë mbetur edhe disa tjera që duhet përmirësuar. Gëlqerja nuk është pasuri nëntokësore, është prodhim i gurit gëlqeror, kjo duhet përmirësohet. Në Kaçanik thuhet se Kaçaniku ka klimë mesdhetare. Gjeografikisht Kaçaniku nuk ka klimë mesdhetare, edhe kjo duhet përmirësuar. Tash për me dhënë analizë më të gjerë, duhet bërë krahasim të KABK 2019-2021, si vizion i kësaj qeverie është së Kaçaniku ka arritur zhvillim të lartë ekonomik në bujqësi, industri, komunitet të shëndetshëm mirë të arsimuar. A janë arritur shtrohet pyetja ? Është thënë se do të bëhen funksionale zonat ekonomike industriale dhe janë planifikuar, 230.000 € për këtë dhe kjo nuk është bërë. Është thënë se do të bëhet restaurimi i monumenteve historike, janë planifikuar 80,000€, kjo nuk është bërë. Është thënë se do të bëhet krijimi i hartës turistike në qytet për vizitorë, kjo nuk është bërë, hartë turistike në qytet nuk ka. Nuk është bërë rritja e numrit të vizitorëve, është thënë se do të bëhet rritja e sipërfaqes së tokave bujqësore, nga 1400 ha në vitin 2015 -2500 ha në vitin 2021, kjo nuk është bërë dhe nuk janë as 1400 ha, sepse tokat bujqësore janë mbushur me dhe prej “Bektel Enka”. Është thënë se do të bëhet ulja e shfrytëzuesve të ndihmës sociale nga 900 familje në vitin 2018 në 500 familje në vitin 2021, kjo nuk është bërë. Është thënë se do të ndërtohen terrenet sportive, nuk janë ndërtuar terrenet sportive. Kaçaniku ma merr mendja është i vetmi qytet i cili nuk ka asnjë terren sportiv për qytetarë. Është thënë se do të bëhet modernizimi i sallës së KK në KABK të kaluar dhe në këtë kornizë. Është thënë se do të bëhet një ekip mobile mjekësore që do ti vizitoj fshatrat me iu dhënë këshilla mjekësore, edhe kjo po përsëritet në kornizën e vitit të kaluar edhe në këtë kornizë. Për projekte të zhvillimit të turizmit, janë planifikuar 110.000 €, unë nuk e di që ka ndonjë projekt të kësaj natyre. Për mua kjo KABK 2022-2024 nuk reflekton objektivat me prioritet të komunës, duke marrë parasysh ato të cilat janë thënë në KABK 2019-2022.

z. Ekrem Raka, Faleminderit, Ky dokument është dokument i hartuar nga ekzekutivi i komunës. Unë personalisht nuk pajtohem me mënyrën si e projekton zhvillimin ekonomik organi ekzekutiv. Projekti i cili me pati pëlqyer, është: Ndërtimi i memorialit për viktimat civile. Tani me duket jo në rregull ky projekt me hyrë në prioritet me 5.000 €. Viktimat civile të luftës janë viktimat tona. Ky projekt ose të hynë me prioritet me mjetet buxhetore të komunës, përndryshe të hiqet nga prioritetet, e mos me prituri ndonjë donator mos po na e ndërton memorialin e viktimave civile.

znj. Rabije Sallahu, Përshëndetje kryesues; Në KAKB 2022-2024 nuk është përfshirë: Asfaltimi i rrugës alternative e fshatit Biçec e as kanalizimi i kësaj rruge. Kërkesa është dorëzuar, ndërkaq nga ministria ka kohë që është thënë se ky projekt do të mbështetet nga niveli qendror.

z. Selim Reka, KABK është një dokument i zhvillimit ekonomik dhe realizimit të projekteve në vija të trasha mund të themi, pasi që mund të ndryshohen prioritetet në procedura të mëtutjeshme varësisht prej nevojave që paraqitën. E mira e kësaj është se, kemi projekte të reja të cilat janë futur në prioritet edhe pse disa janë me 5000 €, të cilat mund të vijnë në radhë me ndonjë donacion edhe para projekteve tjera. E metë e kësaj është së, ka projekte që nuk kanë kosto buxhetore dhe nuk ka ndonjë analizë për to dhe afatet kohore. Problem është uji i pijes

dhe nuk është duke u bërë zgjidhje. Nuk është vetëm Kaçaniku dhe Doganaj, por edhe një pjesë e madhe e qytetit dhe vende tjera në vise të larta të cilat nuk kanë ujë të pijes. Pasi që pjesa më e madhe e prioriteteve janë kryer, është mirë të mendohet për çështjen e ujit të pijes si elementi kryesor i jetës për qytetarët me u bërë një zgjidhje. Uji i pjesës duhet të ketë prioritet në raport me projektet tjera.

z. Bekim Koxha, Faleminderit kryesues; U potencua këtu çështja e projekteve me prioritet – uji i pijes. Kaçaniku ka ujë të mjaftueshëm, ka burime të mjaftueshëm, mirëpo pse ato burime nuk futën në gypa në mënyrë që qytetarët me pasur furnizim më ujë të pijshëm, nuk e di. Pse nuk bëhet diçka me shumë për çështjen e ujit të pijes. U cek se tokat bujqësore do të shtohen dhe do të punohen me shumë. Të zhvillimi bujqësisë, të makinat mbjelëse, të subvencionet në serra në bujqësi, fjalë ka të mjaftueshme, mirëpo në terren, investimet janë të vogla. Burim jetik i jetës është uji, pa ujë, nuk ka as zhvillim ekonomik e as jetë. Prioritet numër 1 duhet të jetë uji i pijes, pastaj te shikohen prioritetet tjera.

z. Hajredin Luta, Përshëndetje; Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit janë paraparë 493.000 €. Ku janë këto pika ku do të intervenohet në ujësjellës.

Në vitin 2016 inxhinieri i komunës i cili merr pagë në komunë, del e bënë projekte private me mjete të taksapaguesve dhe sot e asaj dite ato projekte nuk dihet se çka është bërë me to. Kam pas bërë pyetje dhe me herët dhe është marrë si hajgare kjo punë. Unë dua llogari për projektin për të cilën kemi dhënë para. Pyetja, A hynë në këtë prioritet edhe projekti për të cilin kemi paguar 5500 € apo jo, sepse në 2019 kur është mbajtur dëgjimi publik me qytetar, administratori i fshatit i ka bërë pyetje drejtpërdrejtë drejtorit dhe drejtori ka thënë se kjo çështje është punë e kryer. Tani kam informacione së CDI e ka marrë përsipër këtë projekt në bashkëpunim me komunën dhe bifurkacionin, me participim. Unë nuk e di pse komuna nuk bashkëpunon me CDI dhe bifurkacionin dhe me realizuar këtë projekt. Kërkoj nga drejtori me më dhënë një përgjigje lidhur me këtë projekt.

z. Adnan Reka, Faleminderit kryesues; Unë do të doja të kishte me tepër ndryshim në përmbajtje sesa në formë. Që 4 vite që jam në këtë KK i shoh prioritetet e njëjta dhe objektivat e njëjta. A nuk ka ndërruar asnjë prioritet e asnjë objektivë që 4 vjet. Për me tepër se kjo, unë e kam edhe një pyetje;

Çfarë ndodhi me SHFMU “Emin Duraku”, sepse në këtë kornizë buxhetore, po shohim vetëm një kod buxhetor prej 5,000 eurove. Ndërsa, ju deklaronit edhe nëpër media se këtë vit do të fillojë ndërtimi i shkollës së re në vlerë prej 1.300.000 euro, e që unë konsideroja se ishin pak, sepse unë gjithnjë kisha parasysh numrin e nxënësve, ndërsa ju gjithnjë kishit parasysh rajonin e nxënësve.

Kryesuesi i Kuvendit, Diskutime të tjera nuk ka, atëherë fjalën ia kaloj drejtorit të DEFZH, Bahri Selimi për sqarime të nevojshme në draftin kornizë.

z. Bahri Selimi-drejtor i DEFZH, Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë; Me lejoni të prezantoj në pika të shkurta draftin kornizë. Unë nuk e pash së pati të interesuar sesa e kemi buxhetin, e cila është pjesa kryesore sesa ka mjete buxhetore komuna në vitin 2022, 2023 dhe 2024 dhe si duhet te realizohen objektivat. Në vitin 2022 buxheti i komunës është 9,193.167€, prej tyre GP është 3,501.260 € me një rritje simbolike për 7 %, Granti specifik i arsimit, 3,841.527€, me një rritje për 4.7%, Granti specifik për Shëndetësi, 1,161,004.00€ apo me një rritje për 0.00€. Kemi qëndruar në vit pandemie, bashkë e kemi përjetuar. Në dokumentin të cilin e ka l ‘anësuar MF-qeveria aktuale apo qarkores buxhetore 2022/01 në bazë të cilës hartohet ky dokument, thirret vazhdimisht në menaxhimin e situatës së pandemisë apo dëmet të cilat janë shkaktuar në vitin 2020 nga pandemia, dhe rikuperimin me mjetet vijuese dhe shihet

së është 0.00% rritja. Ekzekutivi komunal nuk e ka aspak të lehtë me bërë shpërndarje buxhetore, mirëpo për kundër vështirësive, kostoja për paga ka arritur 5.2 milion që është pozitive, Mallrat dhe Shërbimet nga 800 mijë në 900 e 9 mijë janë rritur, me qëllim të menaxhimit, pasi nuk të themi ende së pandemia ka kaluar, komuna ende duhet të i mbajë si rezerve, të jetë e përgatitur edhe gjatë vitit 2022 së ndoshta do të ketë nevojë për shpërndarje apo furnizim me pako ushqimore, artikuj higjienik për familjet në nevojë apo atyre të cilët janë prekur nga Covid-19. Shpenzimet komunale kanë shënuar një rritje për 212 në mijë euro, në 221 mijë euro për 8 mijë euro më tepër. Subvencionet dhe transferet i kemi ngritur nga 150 mijë euro në 300 mijë euro në vitin 2022, me qëllim të plotësimit të intervenime shtesë nëse ka nevojë nga pandemia, qoftë në sektorin e bizneseve apo në kulturë nëse ka mbetur ndonjë aktivitet pa realizuar ose që duhet shtuar linjë plus subvencionet në arsim dhe bujqësi të cilat janë paraparë të kenë rritje. Investimet kapitale i kemi rritur për 242. 875 euro, marrin pjesë për 27% në buxhetin total. Të ik u tha se ka projekte të reja në buxhet, sidomos ngritja shkon të rregullimi i sheshit të qytetit-faza e dytë, shuma 100mijë euro, ndërtimi i trotuarit dhe ndri/imi publik në f. Stagovë, 50 mijë euro, kanalizimet fekale vazhdojnë investimet me 110mijë euro, ujësjellës-ndërtimi i rrjeteve të ujësjellësit, 153 mijë euro, ndriçimi publik, 100mijë euro. Projektet zhvillimore në bujqësi, 50 mijë euro, projektet për zhvillimin e turizmit, 50mijë euro. Po ashtu është i specifikuar projekti zhvillimor për turizëm me nr. rendor 30. Ndërtimi dhe rregullimi i Qarshisë së Vjetër, 200mijë euro, rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve në pjesën urbane dhe rurale, 200mijë euro. Të gjithë ata anëtarë që e shohin së komuniteti i tyre nuk është përfshirë në prioritete, ka vend në këtë kod. Të kultura, u tha se nuk ka terren sportive, rregullimi i fushave sportive është i paraparë me theks të veçantë 22 , janë ndarë 70mijë euro, 100mijë euro janë për renovimin e shkollave, duhet përfundon ndërtimi i sallës fizike në shkollën e Begracës, 50 mijë euro, 155mijë euro janë ndarë për sallat tjera sportive të cilat do t'i jep prioritet DAK me vonë. Unë mendoj se pjesa e kornizës fiskale është shumë më e rëndësishme sepse çdo gjë varët nga financat me u realizuar. Të profili ekonomik që ishin o vërejtje, gjithmonë z, Ekrem kur kemi pasur vërejtje i kemi përmirësuar, por nuk është që profili ekonomik ndërron. Nëse doni ato vërejtje edhe i fshijmë krejt edhe KABK miratohet me ato ndryshime. U përmend se jemi të injoruar nga dëgjimi publik për dhënien e ideve të këtij dokument. Dëgjim publik për KBK ka pasur me 21 të këtij muaji, ku marrin pjesë të gjithë qytetarët e interesuar, keni mundur si përfaqësues i qytetarëve me marrë pjesë, me dhënë ide, dëgjimi ka qenë i hapur për të gjithë të interesuarit. U lexua KABK 2021 dhe u tha se nuk janë realizuar prioritet, ndërkaq duhet të keni parasysh faktin së ne ende jemi në vitin 2021. Tani kanë filluar të realizohen projektet, për shkak të kohës, jemi ende në gjysmë të vitit. Të turizmi thatë së nuk është bërë asgjë, ne jemi në lansim të një projekti të turizmit, 50 mijë euro do të investohet në f. Strazhë në trotuar dhe ndriçim publik. Për me në detaje jep drejtorja apo menaxheri i projektit. Memorialin e viktimave të luftës e kemi futur në kod për vitin e ardhshëm, mirëpo sivjet do të realizohet. Rrugë lokale në f. Biçec u përmend një rrugë, kjo do të gjejë vend. Të uji i pijes, z. Selim, gjithmonë janë ndarë mjete, është investuar diçka, DSHPE i ka të dhënat se ku është investuar, ndërkaq pse s'po bëhet zgjidhje, është shqetësim i të gjithëve. Të prioritetet, objektivat të cilat i potencoj Adnani, objektivat janë afatgjate por të nevojshme dhe të qëndrueshme për zhvillimin e komunës Nëse e keni lexuar materialin, ka disa shtesa në prioritete, ndërrime të realizohen objektivat ashtu siç janë paraparë, se ato nuk ndërrohen janë afatgjate, një qëllim e kemi, nuk mundemi me ia ndërruar komplet orientimin komunës, ka disa të arsimit, të administrata, të bujqësisë. Të SHF 'Emin Duraku' është futur në prioritet, presim investim nga MASHT,

Kryesuesi i Kuvendit, Faleminderit drejtor, KABK është dokument i cili i paraprinë projeksioneve buxhetore 2022-2024. Ky dokument mund të ketë ndryshime gjatë kohës deri me miratimin final të buxhetit, jo në shuma, por në projekte. Ky dokument ka qenë në debat publik, pastaj projektohet buxheti i cili përsëri i nënshtrohet procedurave të diskutimit publik

nga KPF . Deri me miratimin e buxhetit, mund të ketë përsëri kërkesa nga diskutimet publike, kështu që kemi kohë ende deri me miratimin e buxhetit për me dhënë ide e propozime për projeksionet buxhetore.

z. Ekrem Kyçyku, Të gjitha vërejtjet të cilat i potencova janë marrë nga KBAK. Nëse janë zvogëluar familjet që marrin ndihma sociale, nëse janë rritur tokat bujqësor, nëse është investuar në zonat ekonomike industriale, nëse janë bërë investime në monumente historike, të gjitha këto i pranoj. Ne nuk jemi kundër investimeve, por jemi për realizimin e prioriteteve. Kryetari ka thënë, ndërtimi i Qarshisë në qytet është prioritet i tij, prioritet i tij ka mbetur në vitin e kaluar. Po të krahasojmë realizimin e prioriteteve të komunave si, Viti, Klinë, Malishevë etj. shihet sa çfarë qendrash kanë ndërtuar këto komuna. Kjo nuk është për inati, por të keni prioritete, si uji, kanalizimi, zhvillimi ekonomik, ky është qëllimi.

z. Ekrem Raka, Kryesues faleminderit; Unë nuk thash pse nuk është kryer projekti për memorialin, por thashë së ky projekt të kryhet me mjete buxhetore të komunës e jo me para të donatorëve.

1. Nëse nuk e dinë drejtor, po të sqaroj; Pushteti funksionon në dy mënyra; partia e cila është në pushtet, me partnerët e vet i bënë vet prioritetet dhe nuk e pyet opozitën hiq dhe kur të vjen në KK, opozita nuk ia voton prioritetet, qysh keni vepruar deri tani.

2. Rruga e dytë e qeverisë është; Kur partia në pushtet dokumentet fundamentale duhet me i hartuar në bashkëpunim me opozitën, atëherë kryetari për draftin kornizë i mbledhë përfaqësuesit e opozitës dhe mundohet me hartuar dokumentin në bashkëpunim me opozitën, e jo na me u sjellë si qytetarë të rëndomtë veç me ardhur në debate publike e me ngritur dorën, me thënë kryetar, a ka mundësi të hynë në prioritete ky projekt. Ky dokument për ju është i drejtë, e keni hartuar sipas mendimeve të juaja dhe unë nuk ua votoj.

z. Ramadush Osmani- drejtor i DSHPE, Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë; E ndiej obligim me marrë fjalën, pasi u diskutuan projekte të cilat ndërlidhen drejtpërdrejtë me përgjegjësitë e shërbimeve publike. Të ndërtimi i rrjeteve të ujësjellësve, u potencia edhe gjendja aktuale edhe projeksionet investive. Ajo që e themi edhe si drejtor edhe si qytetar, ujë për higjienë e për pije do të ketë vazhdimisht, ndërkaq ujë për ujitje nga burime nëntokësore, do të kemi telashe edhe 100 vjet. Kjo është realitet. Për këtë arsye duhet të ndajmë ujin për pije dhe higjienë, në raport me ujin për ujitje etj. Sivjet do të investojmë 110€ në rrjete të ujësjellësit, dhe pikërisht do të kapen këto pika të cilat u debatuan sot. Do të shtohet kapaciteti i ujit në rrjetin e ujësjellësit; Dubravë, Doganaj, El;ezaj edhe me 1 burim shtesë, diku 5 litra në sekondë, do të shtohet rrjeti i Glloboqicës me sasi të re të ujit, për shkak se edhe atje kemi probleme në muajt e pikut. Gjithashtu do të bëhet funksional rezervuari 1 milion litra i qytetit dhe do të ndërrohet gypi i azbestit me f 315 dhe do të kemi mundësi ti kapim edhe kuotat në qytet që nuk kanë ujë. Këto janë tri prioritetet e këtij viti. Gjithashtu kemi paraparë edhe furnizim me gyp, komunitetet të cilat kanë gatishmëri për shtimin e kapaciteteve ose me ndërrua gyp brenda ujësjellësit të cilat janë jashtë menaxhimit të komunës. Në projeksione janë paraparë edhe në vitin e ardhëm. Ne jemi në bashkëpunim me CDI dhe bifurkacionin që këta mjete që i parapamë, në koordinim me këta dy akterë i ekzekutojmë, për arsye së çdo investim në rrjetin e ujësjellësit, shkon në menaxhim të kompanisë e cila është e licencuar për këtë lëmi. Është paraparë edhe rrjeti i ujësjellësit në Ivajë në projeksionet e ardhme investive. Se nuk është investuar sivjet e thamë shumë qartë, Ivaja ka ujë, ka rrjete individuale, por tash me projekt do të jetë orientim i gjitha burimeve që i ka aktualisht. Jemi duke shqyrtuar mundësinë edhe të pjesës së kah Kërbliqi, të kaptojmë ujëra dhe të furnizojmë pjesën e cila është kuota me e lartë në bashkëpunim me akterët tjerë. Krahas aspektit tjera që kemi rrjete të ujësjellësit në menaxhim të fshatrave. Strategji e Komunës është që këto rrjete të kalojnë në menaxhim të komunës.

Çështja e Memorialit për viktimë civile, do të dal me konkurs të hapur projektimi dhe ekzekutimi sivjet. Janë të parapara 20 mijë euro, ku do të marrim idetë më të mira që mendojmë për realizimin e projektit. U potencua se kemi projekte të avancuara në krahasim me nevojat. Jemi duke punuar paralelisht në dy aspekte; edhe me tabelat digjitale, edhe trajtimin e qenve endacak. E keni parë në faqen e komunës, veç është proceduar trajtimi i qenve endacak, sepse është në kompetenca të drejtorisë. Projekti 23 ka një gabim teknik, rregullimi i dy shtretërve, duhet të jetë “rregullimi i dy shëtitoreve”, sepse ka nevojë të investohet në shëtitoret ekzistuese -në rehabilitim të kubzave dhe të barrierave. Parqet publike sivjet do t’i finalizojmë, projekti është hartuar, është në procedurë të tenderit. Iu themi me përgjegjësi të plotë së pika ku kemi të bëjmë me menaxhimin e mbeturinave, plani 5 vjeçar komunal 2016-2021, mbi 80 % e objektivave janë realizuar. Në vitin e ardhshëm do të fillojmë me rifreskimin e këtij plani. Përveç objektivave që e ka pasur kompania regjionale të kaloj në kompani komunale, ai do të vazhdoj si objektivë, që besoj së në vitin e ardhshëm do të realizohet. Rritja e vijueshmërisë, shtimi i kapaciteteve teknike, rritja e faturimeve e inkasimit të qytetarëve janë në realizim të projeksione që i kemi pasur.

z. Adnan Reka, Faleminderit kryesues, sa i përket SH “Emin Duraku”, keni deklaruar së në këtë vit do të filloj ndërtimi i shkollës në vlerë 1 milion e 300 mijë euro. Nëse është kjo e njëjtë futja në kod buxhetor dhe ndërtimi i shkollës, dallojnë. Të qentë endacak, edhe me herët keni deklaruar se po bëni trajtimin e qenve endacak, e kam parasysh këtë fakt. Por për fenomenin që po na shfaqen qentë, si kërpudhat pas shiut, që për kundër trajtimit, qentë po vijnë në komunën tonë, kah po vijnë, i keni kamerat e sigurisë, ka edhe dëshmitarë që po deklarojnë po vijnë qentë, këtë fenomen duhet ndaluar.

z. Bekim Koxha, Të çështja ku e potencoj drejtori i DSHPE, së ujë për pije ka boll, unë nuk e di a ka apo jo, unë nuk kam ujë të mjaftueshëm, edhe qytetarët e Koxhajve nuk kanë ujë të mjaftueshëm për pije. Ku është defekti, unë nuk e di, ju ndoshta e din më mirë se ndoshta ujitin njerëzit, por ju duhet me u marrë me atë problem e jo unë. Unë nuk jam shërbime publike, ato janë probleme të drejtorisë, më rëndësi është që ujë nuk ka. Pse nuk ka ujë, së është menaxhimi i dobët. Me kanë menaxhimi i mirë, ka ujë, sepse e ndalë atë që ujitë, e ndalë keqpërdoruesit dhe i dënon. A ke dënuar ndonjë qytetarë që ka keqpërdorur ujë, jo. Unë nuk e di së është dënuar ndonjë qytetarë për keqpërdorim të ujit. Të mbeturinat, unë nuk e di drejtor kur thua se 80% e kam realizuar planin. Unë nuk e di ku hedhen mbeturinat e ngurta në Komunën e Kaçanikut, unë nuk e di se ku është lokacioni? Ne tregoni lokacionin se ku duhet qytetarët ‘ti hedhin mbeturinat e ngurta. Të ujërat, lumi Lepenc është degraduar nga ndërtimet e hidrocentraleve, ujë nuk ka me i ujitur tokat. Të kanalet e ujitjes, keni investuar në kanale të ujitjes, janë prishur se janë ndërtuar me zhavorr, nuk është hedhur beton, mundesh me i parë, qytetarët ankohen. Tokat bujqësore janë mbushur me dhe, i keni shkatërruar, i keni bërë djerrina, qysh unë mundem me shkuar me mbjellë tokën time kur e keni mbushur me dhe nga “Bektel Enka”. Unë nuk mundem me shkuar e me mbjellë. Toka është në emrin tim, por ka mbetur djerrinë, sepse është mbushur me dhe. Për këtë do t’i bëjë padi komunës që keni lejuar me u mbushur tokat bujqësore me dhe. Problemi është të Ekzekutivi e jo të Kuvendi. Ne kemi folur sa herë këtu, por nuk kemi mundur me ndikuar se jemi kanë të pafuqishëm si opozitë, ju e keni pasur fuqinë. Nuk kemi mundur me ndalë të keqen. Të lumi Neredime, është turp që krejt mbeturinat e Ferizajt vijnë përmes lumit në Komunën e Kaçanikut, kjo është turp. Pse vijnë, së nuk ka zot shtëpie.

z. Hajredin Luta, Unë e parashtrova një pyetje, drejtori e dha një përgjigje. Sa e shoh unë, KABK 2022-2024 nuk ka ndryshim të prioriteteve.

Kryesuesi i Kuvendit, Diskutime të tjera nuk ka, atëherë KABK për vitin 2022-2024 e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u miratua me 17 votë Për, Kundër ishin 9 anëtarë. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori, prezent ishin 26 anëtarë.

VENDIM

Për Aprovimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore e Komunës (KABK) për vitet 2022-2024 dhe e njëjta lëshohet në procedurën e Diskutimit publik me qytetarë të komunës / Lënda: 01Nr. 400/03-17423/21.

3. Propozim Rregullore e brendshme për përdorimin e automjeteve zyrtare;

Kryesuesi i Kuvendit, Drejtori i administratës e ka hartuar një draft të rregullores, drejtori është këtu, nëse ka kush diçka në këtë pikë e hapi diskutimin;

z. Ekrem Raka, Të neni 3.1 kërkoj të bëhet një plotësim, këtij paragrafi t'i shtohet pasuesi "vetëm për punë zyrtare", se kështu qysh është, lejon mundësinë të përdoret edhe për punë private 24 orë.

z. Selim Reka, Faleminderit kryesues; Pajtohem me propozimin e Ekremit, e kisha edhe një vërejtje, tani e kam harruar të cili, nen. Ata të cilët i përdorin veturat private për çështje zyrtare, është një pagesë simbolike, që vërtetë nuk i mbulon shpenzimet. Kërkoj që ajo pagesë të rritet pakëz.

z. Festim Neziraj-drejtor i DAP, Përshëndetje për të gjithë, fillimisht kërkoj ndjesë për kushtet e punës në sallë të KK – për shkak të nxehtësisë, shpresojmë që mbledhjet e ardhshme t'i kemi me klimatizim sallën. Kjo rregullore vjen si rrjedhojë e Auditorit të brendshëm, që veprimtaria e komunës t'i nënshtrohet kontrolleve të jashtme dhe të brendshme. Auditori i brendshëm përmes një procedure që ka zhvilluar, ka rekomanduar që komuna me pas këtë rregullore për përdorimin e veturave zyrtare. Sa për dijeni, kjo veprimtaria e përdorimit të veturave zyrtare, ka mungesë të legjislacionit. Deri sot është rregulluar përmes 2 rregulloreve të UNMIK-ut të cilat për çudi ende janë në fuqi, kështu që ne jemi bazuar edhe në ato rregullore. Të neni 3 pika 1 kryetari ka të drejtë me shfrytëzuar veturën zyrtare 24 orë. Kryetari iu jep llogari qytetarëve, se aktet të cilat i përmenda ia mundësojnë një gjë të tillë. Unë nuk e shoh problematike nëse ia shtojmë pasuesin që u përmend, megjithëse nënkuptohet së vetura zyrtare përdoret për punë zyrtare e jo për punë private. Të kompensimi, mendoj së është dashur me futur çështjen e përdorimit të veturave private në rast nevojë, mirëpo asnjëherë nëse e keni lexuar draftin më vëmendje, nuk rekomandohet përdorimi i veturës private. Kemi mjaft vetura zyrtare që i përmbushin nevojat e ekzekutivit dhe zyrtarëve tjerë publik, pagesa është 12 cent për 1 km për vetura private, por nuk rekomandohen përdorimi i tyre, në rast së ndodhë kemi paraparë këtë pagesë që mos me ra ndeshë me aktet ligjore.

z. Agim Mani, Faleminderit kryesues; Unë e kam lexuar draftin në tërësi, është mirë i hartuar, sa i përket neni 5 të mirëmbajtja dhe servisimi, ka mangësi sa i përket mirëmbajtjes. Nuk munda me kuptuar këtë "vegla për ndreqjen e defekteve dhe mjeteve shtesë" është e paqartë. Tjetër, Kontrollimi i vajti, nuk mendoj së është prioritet. Fjala "veglave" duhet të jetë "pajisjet". Përveç mirëmbajtjes, a e keni përsipër skadimin e regjistrimit të auto veturave zyrtare? DSHMS që i përdor automjetet zyrtare të ndihmës së shpejtë, duhet të kenë kontrollimet preventive teknike. Deri me tani nuk janë bërë këto kontrollime 6 mujore. Këto kontrollime teknike të këtyre auto-veturave nuk kanë dalë në tender. Nëse ndodhë një aksident me automjetet të ndihmës së shpejtë, kjo i bien së nuk kanë pasur kontroll teknike.

z. Festim Neziraj, Të çështja e veglave për ndreqjen e defekteve dhe mjeteve shtesë e cila u potencua, janë veglat e cila i bartë në bagazh çdo veturë, çelësi etj. dhe nuk e shoh problematike këtë pasues. Të regjistrimi dhe mirëmbajtja, DAP çdo vit fillon procedurat përmes Zyrës së prokurimit. Të gjitha veturat që dalin në komunikacion e kanë kontrollin teknike dhe janë të regjistruara. Për çështjen e autoambulancave, unë nuk kam njohuri, kërkoj mirëkuptim, nëse keni opinion, e kishim futur pastaj në rregullore. Përndryshe, prej drejtorisë po më bëjnë me dije se kryhen edhe ato kontrolle. Kjo rregullore është bërë me qëllim të ndërgjegjësimit të zyrtarëve publik të cilët marrin vetura për udhëtime zyrtare, që veturën zyrtare të konsiderojnë si të tyre.

Kryesuesi i Kuvendit, Nëse nuk ka kush diçka, me propozimet e Ekrem Raka dhe Agim Mani, Propozim Rregulloren e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua njëzëri Për. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës e ,

APROVOJ

Rregulloren e brendshme për përdorimin e automjeteve zyrtare / Lënda: 01Nr. 02-60/01-16867/21.

4. Propozim Vendimi për ndryshim plotësimin e vendimit 01Nr. 104/02-36179/19 - për emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve lokale, pas shqyrtimit të ankesave, kërkesave dhe propozimeve nga qytetarët e komunës së Kaçanikut;

Kryesuesi i Kuvendit, Paraprakisht iu njoftoj së nga administratori i f. Biçec, për rrugën alternative të këtij fshati, ka ardhur kërkesa që të shtyhet për muajin korrik, pasi fshati paskan më zhvilluar debat publik dhe qysh vendosë fshati, e sjellin propozimin. Emërtimi i kësaj rruge si është propozuar, është mendimi i komisionit që ka punuar në draftin e propozuar. E hapi diskutimin për këtë pikë;

z. Selim Reka, Faleminderit kryesues, Ne jemi për aprovimin e Propozim Vendimit të komisionit, me përjashtim të rrugës alternative të f. Biçec, kjo të shtyhet ashtu siç ka kërkuar këshilli i fshatit. Emërtimi i rrugës alternative në f. Biçec, kërkoj të mbetet për ndonjë mbledhje tjetër të KK.

z. Ekrem Kyçyku, Për rrugën alternative të f. Biçec, mirë është bërë që paskan ra dakord komuniteti për debatuar këtë çështje.

z. Bekim Koxha, Të rruga që shpie në drejtim të Silcaporit në drejtim të Rakajt, ajo rrugë, nuk jam kundër që është propozuar me iu vendosur emri, Bekim Berisha, por ne kemi pasur edhe aty dëshmorë dhe kemi njerëz të cilët kanë dhënë shumë për lirinë e vendit dhe nuk është pyetur komuniteti i f. Koxhaj asnjëherë për atë rrugë dhe ne nuk do të votojmë këtë pikë.

Kryesuesi i Kuvendit, Mos keni ndonjë propozim konkret Bekim për atë rrugë ?

z. Bekim Koxha, Duhet me biseduar me komunitetin për këtë çështje. Unë jam i pajtimit që kjo rrugë të prolongohet për një mbledhje tjetër.

Kryesuesi i Kuvendit, A jeni që të prolongojmë edhe këtë rrugë të cilën e potencoj Bekim Koxha, për një mbledhje tjetër

z. Agim Mani, Pasi që po ekziston mundësia me lënë për mbledhjen tjetër disa emërtime, e kemi edhe një rrugë kontestuese në f. Stagovë, rruga "Ekrem Gudaqi" në përfundim të rrugës

“Ramadan Dashi”. Prej fillimit ka pasur probleme, po me vjen çudi që administratori nuk paska bërë kërkesë për emërtimin e kësaj rruge.

Kryesuesi i Kuvendit, Rruga të cilën e potencoj Agim Mani, nuk është në Propozim Vendim, kështu që e njëjta mbetet për mbledhjen vijuese. Ne kemi pasur edhe kërkesa për emërtim të rrugëve me emrat e policëve në detyrë. Unë e kam parë të arsyeshme që rruga “Malsor Dashi” figuron nga varrezat e qyteti deri të rruga “Ekrem Gudaqi” unë kisha thënë të jetë nga shtëpia e Xhabirit, ku kryqëzohet rruga teposhtë, se di si quhet ajo pjesë, ashtu i kemi premtuar edhe prindit të tij. Kjo rrugë është malore dhe nuk ka ndonjë emër.

z. Festim Neziraj-drejtor i DAP, Për shkak të punës së madhe që kemi bërë si komision, e shoh të arsyeshme me marrë fjalën. Ky propozim Vendim ka ardhur si rrjedhojë e asaj që u prolonguan disa emërtime para dy viteve dhe sa për sqarim, emërtimet e rrugëve janë shumë me komplekse sesa duken në shikim të parë. Ne kemi marrë vendim me 2/3 në KK për emërtimin e rrugëve, ndërkaq tek tani janë vendosur shenjat, d.m.th. nuk varet çdo gjë nga KK në këtë rast. Meqë u propozuan disa ndryshime, ne qëndrojmë si komision pran propozimeve tona, por ju jeni organi më i lartë që vendosni.

Kryesuesi i Kuvendit, Për mos me ikur konsensusit me të gjerë, duhet ti kemi parasysh propozimet të cilat u dhanë. Rruga e f. Koxhaj dhe rruga alternative në f. Biçec që të tërhiqen sepse do të merret mendimi i qytetarëve për emërtimin e kësaj rruge. Me këto ndryshime edhe propozimin të cilin e dhashë për rrugën “Malsor Dashi” e shtroj në votim këtë pikë:

z. Ekrem Raka, Kryesues, ne bëjmë shkelje procedurale nëse nuk shtrohet në votim fillimisht Propozim Vendimin e komisionit pa ndryshime. Nëse nuk kalon, atëherë shkojmë me votimin e Propozim Vendimit të komisionit me ndryshimet të cilat dolën në KK, nëse pajtohet komisioni.

z. Festim Neziraj, Është e drejtë morale me treguar për punën të cilën e kemi bërë si komision. Materiali ka ardhur si rezultat i konsultimeve, megjithatë ne pajtohemi me propozimet të cilat dolën nga KK, sepse ky komision ka dal nga ky KK dhe është produkt i këtij KK.

Kryesuesi i Kuvendit, Propozim Vendimin me ndryshimet të cilat dolën e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i komunës mori këtë:

VENDIM

Për ndryshim plotësimin e vendimit 01Nr. 104/02-36179/19 - për emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve lokale, pas shqyrtimit të ankesave, kërkesave dhe propozimeve nga qytetarët e komunës së Kaçanikut/ Lënda: 01Nr. 02-060/01-17365/21.

5. Zëvendësimi i anëtares së KPF nga NISMA, Hafize Sallahi pas kalimit të saj në subjekt tjetër politik- AAK;

Kryesuesi i Kuvendit, Anëtarja e KPF nga NISMA, Hafize Sallahu e ka kaluar në subjekt tjetër politik, zëvendësohet nga NISMA. NISMA nuk ka ndonjë anëtar tjetër përpos Bekimit, atëherë me pëlqimin e Bekimit e bëjmë këtë zëvendësim në KPF.

z. Bekim Koxha, Faleminderit kryesues, unë jam i gatshëm që të jam anëtar i KPF.

Kryesuesi i Kuvendit, Propozimin për zëvendësimin e Hafize Sallahi me anëtarin nga NISMA Bekim Koxha e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i komunës mori këtë ,

VENDIM

Zëvendësimi i anëtares së KPF nga NISMA, Hafize Sallahi pas kalimit të saj në subjekt tjetër politik- AAK, me anëtarin nga NISMA, Bekim Koxha/ Lënda: 01Nr. 60/01-18413/21.

6. Propozim Vendimi për rialokim të mjeteve, sipas buxhetit të vitit 2021;

Kryesuesi i Kuvendit, Bëhet fjalë për një shumë të vogël të mjeteve për rialokim nga një projekt në një projekt tjetër. Kryetari shkoj, drejtori shkoj, nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

znj. Kaltrina Kodra (Tafili), Kërkoj një sqarim, ne si LVV mendojmë së kjo shumë është shumë e vogël, duhet ndajmë një shumë me të madhe. Kjo shumë që është ndarë tani-është për me u rialokuar, është në kohë jo të duhur në këtë periudhë- në kohë fushate. Ne mendojmë se duhet të ndahet një shumë më e madhe për këtë projekt.

Kryesuesi i Kuvendit, Kur do që ndahen mjete për një projekt është kohë e duhur, mos e përmend fushatën, se nuk bëjmë fushatë me varrezat, kështu që, më mirë është më i orientuar mjetet diku sesa me i lënë në vend. Kemi me ndarë edhe shuma me të mëdha, duhet kuptuar çka është rialokimi dhe çka është ai projekti që bëhet fushatë.

z. Agim Mani, Unë jam anëtar i KK që 2 vite dhe gati në çdo të dytën mbledhje kemi rialokim të mjeteve. Me rialokuar mjete për realizimit të projektit me shumën 5000 € në këtë kohë, edhe unë mendoj se është fushatë, për faktin së ky projekt nuk është bërë me herët.

z. Ramadush Osmani, Këto mjete janë rialokuar për rregullimin e varrezave, projekt ky i vazhdueshëm, sepse po vdesin veteranët dhe duhet t'iu rregullohen varrezat e tyre. Kur parashihet një shumë për një vit, mund të dalë shuma me e madhe dhe kjo imponon me kalkuluar sesa kushton rregullimi i një varrezë. Kjo është arsyeja e rialokimit të mjeteve brenda drejtorisë së arsimit, ndërsa këto të cilat i ke parë, ne veç e kemi lidhur kontratën për mirëmbajtjen e hapësirave gjelbëruese, edhe kemi filluar. Është duke pastruar lumi Neredime, do të bëhet pastrimi i varrezave të dëshmorëve, kositja e barit është mirëmbajtje e vazhdueshme, kjo nuk ka të bëjë me shumën 5000€.

z. Adnan Reka, Unë e pata një pyetje; A është bartje, transfer apo rialokim, por qëllimi është i njëjtë. A është i njëjtë kjo, unë nuk e kam të qartë ? Nëse është ashtu, atëherë pyetja pse nuk e keni në buxhet me i mirëmbajtur edhe varrezat e dëshmorëve ? Kjo thjeshtë nuk është rastësi dhe befasi, është një planifikim i cili bëhet paraprakisht, por na thoni që është keq-planifikim buxhetor, o thoni së para fushate i transferoni mjetet nga një vend në një vend tjetër.

Kryesuesi i Kuvendit, Unë nuk po dua me hyrë në këtë çështje se edhe ju e dini çështjen e rialokimeve të mjeteve buxhetore. Nëse thoni së është planifikim i keq, nuk mundesh asnjëherë me i planifikuar çështjet në saktësi. A duhet me u planifikuar më mirë, duhet gjithsesi me përafruar planifikimin me atë që mendojmë me realizuar. Ne rialokimet, transferet, bartjet, keni të drejtë, sepse duhet me i thirrur me një emër. Këto çështje janë për shkak së çdo herë kompanitë e marrin projektin nën çmimin e paraparë të projektit. Vërejtja duhet të jetë të menaxhimi i projekteve, pse nuk bëjnë trysni kompanive me konkurruar me çmime me të larta,

me bërë punën me kualitative, këtu është esenca që riallokohen mjete të ekzekutimi i punimeve duhet me pasur mbikëqyrje me të madhe e pastaj kompanitë ta rishikojnë mundësinë e tyre me konkurruar për projekte. Vërtetë ka konkurrencë në projekte që është qesharake, që nuk ta kap asnjë matematikë me çfarë çmimi hyjnë në konkurrencë. Këtu është ajo që duhet pasur parasysh, mos me na mbetur mjete, përndryshe sa herë kemi me pasur riallokime, sepse mjetet duhet me i orientuar diku tjetër.

z. Bekim Koxha, Faleminderit kryesues; Është vërtetë së rregullimi i varrezave është shumë i nevojshëm dhe shuma 5/000 € të cilat janë ndarë, nuk janë të mjaftueshme, sepse unë nuk e shoh së është duke u investuar diçka të varrezat e dëshmorëve. Ka punë aty të cilat kanë mbetur në gjysmë, nuk është investuar flakadani, edhe këtu e kam kërkuar, që vërtetë aty të bëhet një flakadan, të ndezët zjarri, e jo me ndezë me benzinë. Pse mos të bëhet aty një flakadan, ashtu siç e parashohin rregullat e ndezjes së tij, me u bërë projekti i mirë e të investohet një herë e përgjithmonë në këtë projekt. Ato bure me i marrë e me i rregulluar, se vërtetë se ai vend është një pasqyrë e komunës për qytetarët. Të bëhet diçka, të rregullohet mirë, të ujitën gjelbërimi, lulet, pemët. Mjetet e ndara janë pakë, në të ardhmen të parashihen më tepër mjete, që ai projekt të përfundon një herë e përgjithmonë, në mënyrë që të shtohet hijeshia memorialit të varrezave të dëshmorëve.

z. Adnan Reka, Unë e kam një pyetje, prej 12 mbledhjeve të KK, A mund të m tregoni, sa herë kemi bërë riallokim të mjeteve ? Unë themi me përgjigje të plotë, së në 7-8 mbledhje ka pasur riallokim të mjeteve. Nëse ne në çdo mbledhje bëjmë riallokim, transfer, bartje të mjeteve, kjo është qesharake. Ne jemi për 5.000 €, edhe për me tepër, por të jetë i planifikuar mirë buxheti, sepse kjo tregon për planifikim jo të mirë të buxhetit.

z. Ramadush Osmani, Unë nuk po dua me marrë rolin e drejtorit të financave. Transferi me riallokimin, dallojnë. Riallokimi është kur mjetet mbesin nga i njëjti program buxhetor, dhe kemi të drejtë me i riallokuar brenda atij programi buxhetor komplet shumën e mbetur. Ndërkaq, nëse mjetet mbesin nga një program tjetër shpenzues dhe i bartim për shpenzim në një program tjetër buxhetor, ajo quhet transfer, dhe kemi të drejtë deri në 15% me i transferuar. Po flasim për një rregullim të vazhdueshëm të varrezave të dëshmorëve, edhe unë jam me i hyrë kësaj pune edhe një herë në detaje, me flakadan e më krejt, me propozuar shumën me buxhet, ajo nuk do të jetë 20 mijë euro, por me e madhe e cila hynë në prioritetet tjera. Do të vazhdoj kjo edhe vitin tjetër, se mund të kemi veteran që do të vdesin dhe mund të kemi obligim pas 1 viti me i mirëmbajtur varrezat.

Kryesuesi i Kuvendit, Diskutime të tjera nuk ka, atëherë këtë çështje e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua me shumicën e votave Për, Kundër votë nuk pati, Abstenuan 8 anëtarë (7 anëtarët nga LVV dhe Ekrem Raka). Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për riallokim të mjeteve, sipas buxhetit të vitit 2021/ Lënda: 01Nr. 400/01-17465/21.

Diçka tjetër për këtë takim nuk pati, kështu që Kryesuesi i Kuvendit e konstatoj mbledhjen të përfunduar në ora 12:25. Deri fund të mbledhjes qëndruan 26 anëtarë të gjithë, sa ishin edhe në fillim të mbledhjes.

Procesmbajtës
Makfire Malsiu

M Malsiu





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

- Kuvendi i Komunës-

REGJISTËR I ANTARËVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS KAÇANIK
(zgjedhur në votimet e 22 Tetorit 2017)

Evidenca e pjesëmarrjes së anëtarëve të Kuvendit të Komunës, në mbledhjen e VII-të (Shtatë) të Rregullt për vitin 2021, mbajtur më 30 Qershor 2021

1	2	3	4	5
Nr. R	Emri dhe Mbiemri	pozita	Përkatësia Politike	Nënshkrimi
01.	Hamid Guri	anëtar	PDK	
02.	Ahmet Luma	"	PDK	
03.	Kadri Krivenjeva	"	PDK	
04.	Besim Vishi	"	Nga PDK/ në LVV	
05.	Sali Malsiu	"	PDK	
06.	Lirije Dema	"	PDK	
07.	Pranverë Loku-Zharku	"	PDK	
08.	Lirije Luta	"	PDK	
09.	Vlora Dallosi	"	PDK	
10.	Nexhat Loku	"	PDK	
11.	Agim Mani	"	LVV	
12.	Adnan Reka	"	LVV	
13.	Ekrem Kyçyku	"	LVV	
14.	Fatijona Kyçyku	"	LVV	
15.	Kaltrina Kodra	"	LVV	
16.	Selim Reka	"	LDK	
17.	Besnik Salihu	"	LDK	
18.	Nazife Krasniqi	"	LDK	
19.	Arlinda Rakoci-Raka	"	LDK	
20.	Shemsedin Luzha	"	Nga AAK/ në Grup të Pavarur (GP) nga GP/ i Pavarur/ i Pavarur nga i Pavarur në LVV-	
21.	Albana Lika	"	Nga AAK/ në Grup të Pavarur (GP) Nga GP në LVV	
22.	Rabije Sallahi	"	AAK	
23.	Hajredin Luta	"	Nga AAK/ në Grup të Pavarur	
24.	Hafize Sallahi	"	Nga NISMA/ në AAK	
25.	Bekim Koxha	"	NISMA	
26.	Ekrem Raka	"	IQ Lista për Kaçanikun	

Vërtetoj: Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik/Municipality of Kačanik
Drejtoria e Administratës së Përgjithshme
Direkcija za Opštu Upravu/Department of General Administration



LISTË DISTRIBUIMI/ CIRKULARNO PISMO/ ROUTING SLIP

REFERENCE:					
PËR/ZA/TO:		Anëtarin e Kuvendit- Z. Hajredin Luta			
KOPJE:					
PËRMES/PREKO/THROUGH:		//			
NGA/OD/FROM:		Festim Neziraj - Drejtori i DAP			
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:		Përgjigje			
Nr. i zyrës:		Lokacioni:		Data:	30.07.2021
Br. kancelarije:		Kucni:		Datum:	
Room No.:		Extension:		Date:	
PËR NJOFTIM					☒
AFATI/KRAJNI ROK/DEADLINE					0

Përschëndetje i nderuar,

Në mbledhjen e kaluar keni bërë pyetje lidhur me shqetësimin tuaj se pse duhet të paguaj deklaratë te noteri për ndërrimin e emrit të fëmijës e në komunat tjera kjo gjë nuk kërkohet.

Për informimin tuaj ju përgjigjem se në bazë të nenit 12, të Udhëzimit Administrativ (MPB) Nr. 19/2015 për Kushtet dhe Procedurat e Ndërrimit dhe Korrigjimit të Emrit Personal, që flet për dëshmitë që duhet plotësuar pala për ndërrimin e emrit personal të fëmijës, përveç pikave tjera, në paragrafin 1.3 kërkohet "Deklarata e të dy prindërve ose e kujdestarit" e cila rrjedhimisht bëhet te Noteri sipas Ligjit.

Ndërkohë, se si i kanë rregulluar çështjet në fjalë komunat tjera mbetet në diskrecion dhe përgjegjësi të tyre!

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipality of Kaçanik

Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave

Kaçanik, 29.07.2021

Për: Anëtarët e Kuvendit/ z. Ekrem Kyçyku
z. Bekim Koxha
znj. Nazife Krasniqi
znj. Kaltrina Kodra (Tafili)
z. Agim Mani
z. Selim Reka

Lënda: PËRGJIGJE
Të nderuar,

Më lejoni t'ju përgjigjem dhe jap sqarime zyrtare lidhur me pyetjet/kërkesat tuaja, të parashtruar para Kuvendit të Komunës, më datë 30.06.2021, të cilat ndërlidhen me detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë së Emergjencave dhe Shërbimeve Publike.

z. Ekrem Kyçyku, Faleminderit kryesues, iu përshëndes të gjithëve;

1. E kam një kërkesë prej banorëve të f. Llanishtë, për asfaltimin e rrugës, pasi që është i vetmi fshat që nuk e ka të asfaltuar rrugën kryesore. Ata pyesin se kur do të asfaltohet rruga ?
2. Disa banorë të lagjes Rakoci, të ura - të Matlumlë, kanë shqetësime natën së të rinjtë po rrinë të ura me llastra që është për këmbësor dhe kanë shqetësim për urën për shkak të nxehtësisë dhe zhurma që po krijohet është e padurueshme. Duhet me bërë një zgjedhje, ose me ngjitur llastrën me të trashë në pjesën metalike të urës.

- *Rruga e fshatit Llanishtë, si shumica e rrugicave të zonës urbane dhe rurale, do të trajtohen në kuadër të projektit "Rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve në zonën urbane dhe rurale".*
- *Staza për këmbësor përgjatë përrockës së Rakocit është rehabilituar së fundmi duke i ndërruar bazamentin nga materiali i drurit në panelle metalike. Në rast të shkapjes së paneleve nga konstruksioni metalik, ne do të intervenojmë dhe do të saldohet sërish.*

z. Bekim Koxha, Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë; Unë kam një brengë, tani është sezoni i verës dhe uji f. Koxhaj nuk mjafton, jemi në gjendje të mjerueshme. Çka duhet me bërë ekzekutivi me u marrë me këtë çështje, gypa kanë pru, por ujë nuk kanë pru. Ku qëndron problemi ? Pse nuk ka ujë ? Pse banorët e f. Koxhaj gjithmonë - që 20 vjet pas lufte nuk kanë ujë ? Drejtori i DSHPE duhet me dhënë llogari pse Elezajt kanë ujë, pse Koxhaj nuk kanë ujë ?

- *Drejtorja e Shërbimeve Publike ka kërkuar nga KRU Bifurkacioni"-njësia operative në Kaçanik që të filloj me rezervim të ujit për fshatin Koxhaj dhe fshatrat tjera që janë të kyqura në rrjetin e ujësjellëit Doganaj-Elezaj, gjatë periudhës së muajve kur konsumi i ujit është në disproporcion me prurjet nga burimet. Aktualisht është duke u praktikuar rezervimi nga ora 22.00-7.00.*

Poashtu në kuadër të projektit "Ndërtimi i rrjeteve të ujësjellësit", është planifikuar edhe shtim të kapacitetit të ujit në rrjetin e ujësjellësit Dubravë-Doganaj-Elezaj dhe do të filloj të implementohet gjatë këtij viti.

znj. Nazife Krasniqi, Edhe unë e kam një kërkesë, edhe parafolësit e theksuan për çështjen e ujit të pijes. Bekim e përmendi f. Koxhaj. Nuk është puna e mungesës së ujit në f. Koxhaj, edhe Elezajt nuk kanë ujë të pijes të afërmit e mijë. Kërkoj që mundësisht me bërë ndonjë zgjidhje, sepse çka donë me thënë në këto ditë të ngrohta me pasur probleme me ujë.

2. Shëtitores këtu në Kaçanik, në këta 2-3 muaj të nxehtë, duhet me iu kushtuar kujdes më tepër; pastrimit të lumit, ulëseve dhe ndriçimit publik, sepse një pjesë e ndriçimit publik nuk funksionon. Ulëset më i rregulluar edhe pastrimi të lumenjve duhet me iu kushtuar kujdese gjatë sezonit së verës.

- *Drejtoria e Shërbimeve Publike ka kërkuar nga KRU Bifurkacioni"-njësia operative në Kaçanik që të filloj me rezervim të ujit për fshatin Elezaj dhe fshatrat tjera gjatë periudhës së muajve kur konsumi i ujit është në disproporcion me prurjet nga burimet. Aktualisht është duke u praktikuar rezervimi nga ora 22.00-7.00h*
- *Komuna e Kaçanikut ka të kontraktuar kompanitë që përkujdesen për mirëmbajtjen e hapësiravë publike, mirëmbajtjen e rrugëve, mirëmbajtjen e ndriçimit publik dhe aktualisht janë duke u mirëmbajtur në vazhdimësi rrugët dhe hapësirat publike (pastrimi i lumit Nerodime, pastrimi i shetitotrive, ujitja e drunjëve dekorativ, zbrazja e shportave etj.) si dhe rrjeti i ndriçimit publik në zonën urbane dhe ato rurale.*

Me projektin "Ndërtim dhe rregullimi i parqeve publike" do të vendosen edhe ulëset në bulevard dhe shportat e reja për mbeturina.

znj. Kaltrina Kodra (Tafili); Unë po e përsërisë një kërkesë të cilën e kam ngritur gjatë këtyre 4 viteve edhe në Komitetin për Komunitete edhe në Kuvendin e Komunës. Shqetësimi im është së në vendkalimin mbi hekurudhë të SHM "Skënderbeu" dhe të "ETC" nuk ka sinjalizues. Unë kam bërë kërkesë, me u vendosur sinjalizues, personalisht para një jave kam qenë të INFRAKOS dhe e kam pyetur; Pse nuk po vendosen disa sinjalizues në atë pjesë. Drejtori me ka thënë se kemi bërë kërkesë, mirëpo përgjegjës janë ata të INFRAKOS. Ata me thanë se nuk kemi pranuar kurrfarë kërkesë nga komuna me vendosur sinjalizues dhe ata (INFRAKOS) ishin të gatshëm me vendosur sinjalizues. Andaj, iu kisha lutur organeve kompetente për këtë çështje të adresojnë një kërkesë për sinjalizues, sepse ajo pjesë paraqet rrezik për kalimtarë, sidomos për banoret e asaj pjese dhe fëmijët të cilët kalojnë atypari për me shkuar në shkollë.

- *Kërkesa e drejtorisë adresuar Ministrisë së Infrastrukturës, gjegjësisht, Drejtorisë së Hekurudhave të Kosovës, ka të bëjë me vendosjen e laurës mbrojtëse te udhëkryqi afër ETC-së (ngase është kompetencë e tyre) kurse rreth sinjalistikës që kërkohet në këto udhëkryqe; ato ekzistojnë, por nëse është e nevojshme që të vendoset sinjalizim shtesë, Drejtoria e Shërbimeve Publike, ka të kontraktuar kompaninë për mirëmbajtjen dhe rregullimin e sinjalizimit horizontal dhe vertikal dhe do t'i vendosim me kohë.*

z. Agim Mani,

Në rrugën e fshatit Stagovë, gjatë kryerjes së punimeve të shtruarjes se rrugëve me asfalt para 6 viteve, ka mbetur edhe një pjesë e rrugës për fazën e dytë. Kërkoj nga drejtoria e Shërbimeve Publike të jep një përgjigje rreth kësaj çështje.

3. Pengesat në rrugë në f. Stagovë, Kërkesa e qytetarëve ka qenë qysh në vitin e kaluar, për shkak se rruga është shumë e frekuentuar, ka pasur edhe raste me fatalitet, besoj si pasojë e pengesave në rrugë. Para 3-4 ditëve janë vendosur pengesa, por nuk është mbuluar tërë rajoni, Kërkoj që në atë lagje, në rrugën "Ekrem Gudaqi" të vendosën edhe 2 pengesa në rrugë.

- *Rrugicat e fshatit Stagovë, si shumica e rrugicave të zonës urbane dhe rurale, do të trajtohen në kuadër të projektit "Rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve në zonën urbane dhe rurale".*
- *Përmes kontratës "Mirëmbajtja e sinjalizimit horizontal dhe vertikal" janë vendosur barriera (policë të shtrirë) në këtë rrugë. Nëse nga inxhinieri i komunikacionit, vlerësohet që është e nevojshme vendosja e barrierave shtesë, ne do ti vendosim ato.*

z. Selim Reka, Fillimisht e falënderoj drejtorin e DSHPE për kërkesën të cilën e kam ngritur në mbledhjen e kaluar për pasqyrën të Gjimnazi “ ajo është vendosur. Tani është shtruar një kërkesë e natyrës së njëjtë për rrugën kah lagja Kuka që shkon dhe bashkohet me rrugën e Llanishtës. Aty vërtetë është një rrezik i madh, sepse pjesa e rrugës që nuk shihet është bukur e madhe dhe kjo paraqet rrezik për qytetarët që kalojnë atypari.

- *Pas vlerësimit të inxhinierit të komunikacionit, përmes kontratës “Mirëmbajtja e sinjalizimit horizontal dhe vertikal” do të vendosim edhe në këtë segment rrugor reflektues (pasqyrë)*

Ju falënderojmë për bashkëpunimin tuaj!

Me respekt,

Ramadush Osmani

Drejtore i DSHPE-s